

K O N T R A T Ë

E lidhur në Gjakovë, me dt.26.07.2018, në mes të:

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejshëm Autoriteti kontraktues)
dhe

N.P.Sh. "Genci Rol" sh.p.k. – Prishtinë, me nr.biznesit 70218411 (në tekstin e mëtejshëm Kontraktues)

janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS – "Furnizim me perde "

Numri i identifikimit – 632-18-034-136

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë është **Furnizim me perde**, nga Kontraktuesi, sipas specifikave të dhëna nga , Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport, si në vijim:

1.2 Kontrata do të nënshkruhet nga të dy palët kontraktuese dhe hynë në fuqi me **dt.26.07.2018**.

1.3 Planin dinamik për kryerjen e furnizimeve është **30 ditë**.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve është në :

- Pallati i Kulturës "A.Vokshi";
- sh.f.m.u."Z.Rexha"- Gjakovë;
- sh.f.m.u."Y.Morina"- Gjakovë;
- sh.m.e."K.Kusari"- Gjakovë;
- sh.m.u."M.Këpuska"- Gjakovë;
- sh.f.m.u."D.Ahmeti"- Demjan;
- qerdhe "G.Terbeshi"- Gjakovë; dhe
- Drejtoria për Kadastër.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

1.4 Mbikëqyerja dhe pranimi i furnizimeve do të bëhet nga Komisioni për pranim të furnizimeve në përbërje prej :

Për Drejtorinë e Arsimit:

- a) Drejtori i secilës shkollë dhe bashkë me dy anëtarë të asaj shkolle;

Për Drejtorinë për Kadastër e Gjeodezi dhe Drejtorinë e Kulturës caktohen:

- a) Arbër Jusufi - zyrtar i gjeodezisë
- b) Valbone Juniku – zyrtare administrative
- c) Gazmend Radoniqi – zyrtar i gjeodezisë

Menaxhere e projektit është Arbnor Pozhegu, Drejtor i shkollës mesme te ulte “Mazllom Kepuska”, mob.044/639-907.

Menaxheri i Projektit është personi përgjegjës që do të përcjell implementimin e kontratës .

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës është **6.701,60€ (gjashtëmijë e shtatëqind e një euro e gjashtëdhjetë cent)**.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Pageesa bëhet pas dorëzimit të procesit të pranimi të mallit dhe faturës .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimi të *furnizimeve*.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes,

fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshhtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykata Ekonomike në Prishtinë në pajtim me ligjin e Kosovës.


Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Genc Dobroshti	Emri:	Komuna e Gjakovës – Albana Bakalli
Pozita:	Pronar	Pozita:	Menaxhere e Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.07.2018	Data:	26.07.2018
Vula:		Vula:	

1 Xhojuesi
2 Nënshkrimi

Sigurimi dhe montimi i perdeve


Nr. i art.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	Çmimi total me TVSH
1	Furnizimi, transpotimi dhe motimi i perdeve trakë në zyrat e administratës, dhoma mësimi dhe hapësira tjera. - Perdet të jenë nga materiali stof – poliestër, - gjerësia e trakave të jetë 13 cm - Garnishtja (draperi) të jetë nga metali i cili duhet të montohet mirë për muri ose plafonin e hapësirave - Ngjyra e perdeve zgjedhet nga porositësi i tyre. Llogaria bëhet për m2.	m ²	310	12,00	3 720,00 € ✓
2	Furnizimi, transpotimi dhe motimi i perdeve tip Role - 63 me mekanizem komplet me dimensione (1,25 x 1,80) m per 62 dritare. Llogaria bëhet për copë të dritareve sipas dimensioneve të dhëna.	copë	62	14,20	880,40 € ✓
3	Furnizimi, transpotimi, qepja dhe motimi i perdeve nga materiali shtof me përbërje pambuku, të cilat duhet të montohen në draperat ekzistuese me rrathë metalikë të cilët hyjnë në këtë llogari dhe të cilët lidhin perden me draperin. Modeli i perdeve të jetë me vija me ngjyrë kaltër e bardhë ose gjelbërt me nuanca të verdhë e zbehur. Paraprakisht duhet të aprovohet materiali nga menaxheri i shkollës. Llogaria bëhet për montimin e perdeve në draperat ekzistues të dritareve me dimensionet e dhëna dhe për copë të dritares.				
	Perdet të jenë me dimensione (2,10 x 2,40) m.	copë	48	16,00	768,00 € ✓
	Perdet të jenë me dimensione (3,80 x 2,60) m.	copë	20	24,00	480,00 € ✓



3/29

1 *Khofunari*
2 *Mauri*

4	Furnizimi, transpotimi, qepja e perdeve nga materiali peri e thurur nga materiali poliester me gjerësi 280 cm. Materiali të jetë i qëndrueshëm në temperaturën 30 gradë gjatë procesit të larjes dhe pas larjes të mos jetë e nevojshme hekurosja. Perdja duhet të jetë transparente dhe të lejojë depërtimin e dritës. Perdet duhet të qepen sipas porosisë nga menaxheri i kontrates me dimensione të matura në vend. Paraprakisht duhet të aprovohet materiali nga menaxheri i qerdhes. Llogaria bëhet për sigurimin e perdeve të dritareve për m' të materialit:	m'	108	7,90	853,20 € ✓
Gjithsej totali me TVSH					6 701,60 € ✓

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	N.P.Sh. "Genci Rol" Sh.p.k.
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TË OE:	Genci Dobrosi
NËNSHKRIMI:	
DATA:	11.7.2018
VULA:	

IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	NPSH "Genci Rol"
Adresa	Veternik-Prishtinë
Qyteti	Prishtinë
Kodi postar	10000
Kontakti	Genc Dobroshi
Telefoni	044/502-232
Fax	
E-mail	
Numri i	
TVSH	

BANKA	
Emri	Banka Private e Biznesit
Adresa	
Qyteti	Prishtinë
Kodi postar	10000
Shteti	Republika e Kosovës
Llogaria bankare	1300001001165121
IBAN (opcionale)	
BIC (opcionale)	

SHËNIME:

VULA E BANKËS +	
NËNSHKRIMI i	
PËRFAQËSUESIT TË BANKËS	
(Të dyja të obligueshme)	



DATA + NËNSHKRIMI i	
MBAJTËSIT TË LLOGARISË:	
(e obligueshme)	

